

Masa për ujitjen e tokave bujqësore

Udhëzues për Aplikues

2020-2021

Përbajtja

<u>1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINACIARE PËR KËTË MASË</u>	3
<u>1.1 HYRJE</u>	3
<u>1.2 OBJEKTIVAT E MASËS</u>	3
<u>1.3 MJETET FINANCIARE</u>	4
<u>1.4 PËRKUFIZIMET KYÇE</u>	4
<u>2. INTENSITETI DHE LARTËSIA E NDIHMËS FINANCIARE, SI DHE APLIKANTËT E PRANUESHËM</u>	5
<u>2.1 INTENSITETI I NDIHMËS</u>	5
<u>2.2 PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË</u>	5
<u>3. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË</u>	5
<u>4. KRITERETE VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË</u>	6
<u>5. KRITERET E PËRZGJEDHJES</u>	8
<u>6. PROCEDURAT E APLIKIMIT</u>	9
<u>7. APLIKIMI</u>	9
<u>8. AFATI I ZBATIMIT</u>	9
<u>9. RREGULLAT PËR SHPENZIMET E PRANUESHME</u>	9
<u>9.1 SHPENZIMET E PAPRANUESHME NË KUADËR TË PROGRAMIT:</u>	10
<u>10. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI</u>	11
<u>10.1 VLERËSIMET DHE PËRZGJEDHJA E APLIKACIONEVE;</u>	11
<u>10.2 KONTROLLAT NË TEREN</u>	11
<u>10.3 RADHITJA NË LISTË</u>	13
<u>11. PROCEDURAT E DHËNIES SË GRANTIT DHE NJOFTIMI I APLIKUESIT</u>	13
<u>13. DISPOZITA TË RËNDËSISHME QE MUND TË JENË SHKAKTAR I REFUZIMIT TË APLIKACIONIT</u>	14
<u>13.1 KONTRATA MES PËRFITUESIT DHE AZHB-SË, BASHKË ME PROCEDURAT E PROKURIMIT</u>	14
<u>MONITORIMI EX-POST</u>	15
<u>14. LISTA E SHTOJCAVE</u>	15
<u>SHTOJCA 1. LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA</u>	15
<u>SHTOJCA 3. PROJEKT PROPOZIMI;</u>	17
<u>SHTOJCA 4. MODELJI I KONTRATËS</u>	17
<u>SHTOJCA 5. PROCEDURAT E PROKURIMIT</u>	21
<u>SHTOJCA 6. FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË PËR MASËN UJITJE</u>	24
<u>KËRKESA PËR PAGESË</u>	24
<u>SHTOJCA 7. FORMULARI I INDIKATORËVE</u>	27
<u>KONTROLL NGA AZHB</u>	27
<u>SHTOJCA 8. FORMA E ANKESËS</u>	28
<u>SHTOJCA 9. LISTA DHE ADRESA E ZYRËS QENDRORE DHE ZYREVE REGIONALE TË AZHB-SË.</u>	29
<u>SHTOJCA 10. PROMOVIMI</u>	30
<u>SHTOJCA 11. DEKLARATA NËN BETIM/ZOTIM</u>	31
<u>SHTOJCA 12. DEKLARATË NËN BETIM</u>	32

1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINACIARE PËR KËTË MASË

1.1 Hyrje


Zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme, si një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës, nuk mund të arrihet pa shfrytëzimin racional të pasurive ujore si dhe pa vodosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes.

Derisa në stinët e tjera, të reshurat janë të mjaftueshme, ato mungojnë gjatë stinës së verës. Prandaj, imponohet nevoja e akumulimit, grumbullimit dhe strukturimit të ujërave, me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjatë verës për nevoja të ujitjes së kulturave bimore.

Gjendja teknike e një pjese të madhe të infrastrukturës së ujitjes nuk është e mirë.

Pendat, rezervuarët e ujit, stacionet e ujitjes, pompat, kanalet, gypat, etj, kanë nevojë për rehabilitim, për ndërtime të reja, si dhe për mirëmbajtje të rregullt. Zhvillimi i bujqësisë intensive dhe konkuruese, në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë, është i pamundur pa zhvillimin e sistemit të ujitjes. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme nëse merren parasysh ndryshimet klimatike të viteve të fundit dhe parashikimet për të ardhmen.

1.2 Objektivat e masës

- 
- Rritja e produktivitetit të prodhimeve bujqësore;
 - Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore;
 - Rritja e aftësive konkuruese të prodhimeve bujqësore;

1.3 Mjetet financiare

Buxheti i paraparë për masën Ujitja e Tokave Bujqësore për Programin e Zhvillim Rural

2020 21 është 800,000.00 €

1.4 Përkufizimet kyçe

Intensiteti i ndihmës – është pjesëmarrja (e shprehur në përqindje) e mjeteve publike në shpenzimet e pranueshme;

Aplikantë – janë personat fizik ose personat juridik që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të prezantuara në këtë dokument dhe të cilët paraqesin kërkesë për të përfituar nga grantet e zhvillimit rural;

Aplikacion – dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkua nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;

Përfitues – përsoni fizik ose personi juridik i cili është deklaruar përfitues pas vlerësimit të aplikacionit dhe që ka nënshkruar kontratë me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;

Thirrja për aplikim – njoftimi publik për pranimin e aplikacioneve;

Kontrata – nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të aplikantit të përzgjedhur dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, sipas modelit të përgatitur, shih Shtojcën nr.4;

Shpenzimet apo investimet e pranueshme – janë shpenzimet apo investimet që përkrahen me mjetë publike, shih Shtojcën nr. 6;

Periudha e monitorimit Ex-post – periudha kohore prej tri (3) vitesh pas përfundimit të investimit, gjatë të cilës përfituesi duhet të ruaj qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave ai është përzgjedhur dhe ka marrë pikë;

Grant – ndihma financiare e pakthyeshme e dhënë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për shpenzimet e pranueshme;

Autoriteti Menaxhues – entitet publik brenda MBPZHR-së i organizuar si Departament me përgjegjësi kryesore në hartimin dhe monitorimin e Programit;

Masa – dokument teknik që paraqet njësinë bazë të Programit dhe pjesët kryesore të saj janë kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve. Masa ka buxhetin e saj përmes të cilës synohet të arrihet ndikim i caktuar. Masa zbatohet përmes thirrjes për aplikim dhe procesit të vlerësimit të projekteve;

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është Agjencia e Pagesave (<http://azhb-ks.net/>) me përgjegjësi kryesore në vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve, si dhe pagesën e shpenzimeve sipas procedurave të parapara;

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është dokument teknik, i cili përcakton *masat e zhvillimit rural*, logjikën e intervenimit dhe ndikimin e pritur të granteve;

Projekt – investimi i planifikuar i dorëzuar nga aplikanti;

Periudha e implementimit të projektit – koha prej nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri te ekzekutimi i pagesës së fundit nga AZHB-ja;

Përzgjedhja – përcaktimi i numrit të pikëve për aplikantët e pranueshëm, radhitja e tyre në listë sipas pikëve dhe deklarimi i tyre „i përzgjedhur për financim“ dhe shpërndarja e mjeteve

financiare duke filluar nga ata në krye të listës.

2. INTENSITETI DHE LARTËSIA E NDIHMËS FINANCIARE, SI DHE APLIKANTËT E PRANUESHËM

2.1 Intensiteti i ndihmës

Ndihma publike është 80 % e shpenzimeve të pranueshme.

Shenim: TVSH-ja është shpenzim i papranueshëm dhe atë e paguan përfituesi! Edhe shpenzimet tjera të papranueshme do të paguhen nga përfituesi.

Çdo tentim për mashtrim (p.sh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, etj.) do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese, që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa.

2.2 PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË

Përfituesit përfundimtar nën këtë masë janë:

- Fermerët, sipas definicionit nga Ligji Nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e
 - Ligjet nr. 03/l-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Shoqatat e përdorueseve të ujit;
- Kompanitë Rajonale të Ujites.

3. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

Pëlqimi nga kompania publike e ujites, në rast se aplikuesi në projektin e tij parashevë shfrytëzimin e sistemit të ujites të kompanive publike.

Dëshmia që fermerë përfitues nga Masa101 "Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore", janë përfshirë në projekt, nëse ka të tillë;

Projekte të pranueshme për financim me mjetet publike janë vetëm projektet që pas përfundimit të investimeve janë në funksion të qëllimit për të cilin është bërë investimi (janë në gjendje për të ujitur tokat bujqësore) dhe kjo duhet të dëshmohet me rastin e kontrollës së fundit në terren. Nëse projektet pas përfundimit të investimit nuk janë funksionale, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike të marrë si paradhënie. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë 3 vjetëve pas realizimit të projektit, aq sa zgjat periudha monitoruese.

Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike gjatë periudhës monitoruse;

Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AzhB-ja.

Në rast se në projekt parashihen ndërtimi, zgjerimi, rehabilitimi, aplikanti duhet të paraqesë edhe:

Projektin ideor (teknik) me paramasë dhe parallogari të investimeve
Pëlqimin e komunës që dëshmon se ne rast të dhënes së grantit, aplikues imund të marrë leje ndërtimi

Në rast të përzgjedhjes së projektit, para nënshkrimit të kontratës, përfituesi duhet të dorëzojë:

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës
- Projektin e detajuar, me paramasë dhe parallogari;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse parashihet me ligj;

Shenim: është e rëndësishme që tatimet të paguhen edhe gjatë zbatimit të projektit dhe në periudhën e monitorimit Ex-post (3 vjet pas zbatimit të projektit). Përfituesit, të cilët do të gjenden me tatime të papaguara gjatë afateve të përmendura, do të jenë të detyruar ta kthejnë në tërësi vlerën e financuar të përkrahjes publike, si dhe i nënshtrohet ndëshkimeve të parapara me ligj

4. KRITERETE VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË

Projekti ideor teknik i dorëzuar duhet të demonstrojë zvogëlimin e humbjeve të ujit në minimum 20%, në rastet e modernizimit të sistemeve ekzistuese të ujitjes.

Përfituesi duhet të kontraktojë kompani ndërtimi me përvojë të mëhershme në tri vjetët e fundit në ndërtimin e sistemeve të ujitjes dhe ujërave që kërkohen në projekt dhe e cila do të garantojë për punët e ndërtimit për së paku 3 vjet pas finalizimit të punës.

Kompania e kontraktuar duhet të respektojë kriteret e Udhëzimit Administrativ për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural **2020-21**, si dhe legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

Përfituesi duhet të dorëzojë deklaratë me shkrim përmes së cilës garanton se do të participojë me 20% të shumës totale të miratuar për realizimin e projektit.

Sipërfaqja minimale e projektit nën ujitje duhet të jetë 10 ha.

Aplikuesit duhet të dëshmojnë të drejtat pronësore të tokës së tyre dhe të gjitha tokave të fermerëve të tjera ku do të bëhet investimi i propozuar që nënkupton tërë sipërfaqen nëpër të cilën kalon sistemi i ujitjes dhe tokat që do të ujiten, si dhe pëlqimin me shkrim (deklaratë e nënshkruar e cila përbën edhe nr. e parcelës për të cilën jepet pëlqimi) dhe të dhënat personale (kopja e letërnjoftimit) nga pronarët e tokave për investimin që do të bëhet. E drejta pronësore dëshmohet përmes certifikatës së pronës (fleta poseduese). E drejta pronësore pranohet edhe kur pronari i tokës dhe shfrytëzuesi i tokës që do të përfshihet në investim/ujitje janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh. stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, mbesat e kështu me radhë.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës, certifikatës së lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes. Po ashtu, shfrytëzuesi i tokës që do të përfshihet në investim/ujitje duhet të plotësojë Deklaratën nën betim, me të cilën dëshmon se toka me të cilën aplikon është në trashëgimi të tij. Tokat e marra me qira së paku 10 vjet, e noterizuar.

Vlera e shpenzimeve të pranueshme

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, kurse vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 200,000 €;

Shkalla e përkrahjes publike

Përkrahja publike është 80% e shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 për masën Ujitjes së tokave Bujqësore është 600,000 € për përfitues.

Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e lartpërmendur.

INVESTIMET E PRANUESHME

Reabilitimi dhe zgjerimi i kanaleve dhe gypave të ujitjes;

Ndërtimi i rezervarëve të ujit;

Penda e ujitjes;

Hapja e puseve me kusht që pusi të ketë ujë;

Ndërtimi i drenazhës/kullimit;

Pompat e ujitjes dhe paisjet e tjera përcjellese (paisje për matjen e ujit, për rrymë, etj);

Reabilitimi i paisjeve (valvulat, lidhëset, gypat, përfshirë edhe punën);

Punët përcjellëse me ndikim në mjedis, drenazhim (tarracat, niveli i tokës, varësisht nga lloji i projektit).

Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt-propozimit nuk mund te tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve te pranueshme por jo me shum se 1,000.00 euro. Në rast të investimeve që parashohin; skica, dizajnime te hollësishme inxhinjerike, vlerësim te ndikimit në mjedis janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 3,000.00 euro. Të sillet projekti me dizajnim dhe paramas pasi të nëshkruhet kontrata.

5. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Tabela 1. Kriteret e përzgjedhjes për masën e ujitjes së tokave bujqësore

Kriteri	Parametri	Nr. i pikëvee
Kostot-efektive për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitura dhe rehabilitimin e rrjeteve ekzistuese të ujitjes	<p>Metoda e kalkulimit:</p> <p>Pasi të jenë vlerësuar të gjitha projektet, nga projektet e pranueshme do të krijohet një hierarki e kostove për ha, duke filluar nga më e ulëta deri te më e larta.</p> <p>Projekti me koston më të ulët do të marrë numrin maksimal të pikëve, ndërsa projekti me koston më të lartë për ha do të marrë 0 (zero) pikë.</p> <p>Pjesa tjetër e projekteve të pranueshme do të marrë pikët (me 2 decimale) sipas këtij kriteri bazë të kostos së tyre për ha, ndërsa rezultatet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë.</p> <p>Kalkulimi për poentim: $15 * (\text{Cp}-\text{maxC}) / (\text{minC}-\text{maxC})$</p> <p>Cp - kosto për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar për ujite, e projektit që vlerësohet.</p> <p>Min C - vlera e shpenzime për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar të ujitjes, e projektit me vlerën më të vogël për hektar.</p> <p>maxC - vlera e shpenzime për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar të ujitjes, e projektit me vlerën më të madhe për hektar.</p>	Max. 15
Sipërfaqja e ujitur (ha)	$\geq 10 - < 30 \text{ ha}$ $\geq 30 - < 50 \text{ ha}$ $\geq 50 - < 75 \text{ ha}$ $\geq 75 \text{ ha}$	20 25 35 40
Aplikuesi është anëtar i shoqatës së përdoruesve të ujit për ujite të tokave bujqësore Kompanitë Rajonale të Ujitjes		10
Numri i fermerëve të regjistruar në Regjistrin e Fermës që përfitojnë nga projekti	1 - 10 11 - 20 më shumë se 20	10 15 20
Realizimi i projektit përfshinë përfitues të Masës 101 "Investimet në asetat fizike të ekonomive bujqësore" në tri vitet e fundit	1 - 5 më shumë se 5	10 15

Totali	100
--------	-----

Shenim: Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

6. PROCEDURAT E APLIKIMIT

Përbajta e aplikacionit

Shënim: Për të qenë i pranueshëm aplikacioni duhet të përbajë të gjitha dokumentet e rradhitura në listën e paraqitur në Shtojcën nr. 1.

7. APLIKIMI

Aplikimi bëhet përmes web-modulit online në web-faqen e AZHB-se www.azhb-ks.net, në të cilën gjendet linku “aplikimi online” që dërgon në modulin e [aplikimit online PZHR](#). Në web-modul regjistrohet projekti si dhe ngarkohen (upload) dokumentet e nevojshme për aplikim në PDF.

Pas përfundimit të procesit të aplikimit online, fillon shqyrtimi administrativ i aplikacioneve;

Shënim -Pas përbylljes së procesit të aplikimit online, fermeri është i obliguar që origjinalin e aplikimit (dosjen) ta ruaj për një afat kohorë prej 3 viteve në mënyrë që ta ketë në dispozicion kur t'i kërkohet nga zyrtarët e AZHB-së.

Thirrja për aplikim dhe afati i fundit

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftimi publikohet në ueb faqen e internetit të MBPZHR-së: <http://www.mbpzhr-ks.net/> dhe në ueb faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë <http://www.azhb-ks.net/> dhe mediat e shkruara dhe elektronike të Republikës së Kosovës.

Afati i fundit për aplikim është deri sa të përfundon kampanja e thirrjes për aplikim.

8. AFATI I ZBATIMIT

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 180 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas periudhës prej 180 ditëve, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë, në rast se përfituesi nuk arrin të përfundojë projektin në afat prej 180 ditëve të parapara me kontratë për shkak të kushteve atmosferike, AzHB-ja mund të zgjasë afatin me aneks kontratë për një afat të caktuar.

9. RREGULLAT PËR SHPENZIMET E PRANUESHME

Paratë e projektit mund të merren vetëm pasi përfituesi ka realizuar investimin dhe ka paguar faturat në përputhje me aplikacionin e tij dhe kontratën të cilën e ka nënshkruar me Agjencinë për

Zhvillimin e Bujqësisë (shih shtojca nr. 6, listën e investimeve të pranueshme).

Shpenzimet janë të pranueshme vetëm nëse ato ndodhin pas nënshkrimit të Kontratës në mes të aplikuesit dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me përjashtim të shpenzimeve administrative, të cilat mund të ndodhin para nënshkrimit të kontratës, por ato u pranohen vetëm aplikuesve të përzgjedhur.

Shpenzimet administrative siç janë: pagesat për arkitekt, inxhinierë, si dhe pagesat për konsultime, për studime fizibiliteti, përvetësim i të drejtave patentore dhe licencave. Shuma maksimale e pranueshme për këto shpenzime nuk duhet të tejkalojë 10% të shpenzimeve të pranueshme. Shpenzimet për përgatitjen e projekt-propozimeve dhe planeve të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 3% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 1,000.00 euro të shpenzimeve të pranueshme.

Në rast të investimeve që parahinen skica dizajn të rëndësishëm inxhenjerik vlersim të ndikimit në mjedis shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier leje dhe licensa të ndryshme janë të pranueshme deri në vlerën 7%, por jo më shumë se 3,000.00 euro.

Këto shpenzime janë të pranueshme në mënyrë retroaktive vetëm për përfituesit përfundimtarë.

9.1 Shpenzimet e papranueshme në kuadër të programit:

- (a) taksat, përfshirë TVSH-në; me përjashtim të TVSH-së së pa - kthyeshme për personat fizikë dhe ndërmarrjet jo-raportuese të TVSH-së;
- (b) taksat doganore dhe akcizat
- (c) blerja dhe qiraja e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
- (d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e proceseve gjyqësore;
- (e) shpenzimet operative;
- (f) makineri edhe paisje të përdorura;
- (g) detyrimet bankare, kamatat, shpenzimet e garantuesit dhe detyrimet e ngashme;
- (h) kostot e këmbimit, detyrimet dhe humbjet e këmbimit, si dhe shpenzime tjera financiare;
- (i) kontributet në natyrë;
- (j) blerja e inputeve bujqësore, kafshëve, bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
- (k) shpenzimet e mirëmbajtjes dhe amortizimit
- (l) shpenzimet për pagat e stafit të punësuar për aktivitetet e menaxhimit, implementimit, monitorimit dhe kontrollimit.

Shpenzimet e papranueshme janë çështje e përfituesit, prandaj ato nuk duhet të përfshihen në kërkësen për pagesë, kështu që përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre. Për shpenzimet e papranueshme nuk është e nevojshme të respektohen procedurat e prokurimit.

Çdo tentim për mashtirim (psh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është

subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës.

10. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI

10.1 Vlerësimet dhe përzgjedhja e aplikacioneve;

Procedura e përzgjedhjes do të bazohet në një sistem të renditjes së kritereve të përzgjedhjes, e cila do të zhvillohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, si pjesë e thirrjes publike për aplikim për përzgjedhjen e masës së ujijtjes.

Kontrolla administrative vlerësimi i projekteve dhe kontrollat në terren do të bëhen nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë .

10.2 Kontrollat në teren

Projektet e përzgjedhura për financim u nënshtronen kontolleve në terren për të verifikuar gjendjen faktike të propozimeve për investime, nëse investimi ka filluar dhe shpenzimet janë realizuar, nëse informacioni në dokumentet e parashtruara korrespondon me gjendjen reale dhe masat tjera.

Do të kryhen së paku 3 kontolle në terren:

1. **Kontrolli i Parë** (kontrolli para miratimit),
2. **Kontrolli i Dytë** (kontrolli pas investimit e para pagesës),
3. **Ex-post Kontrolli** (Monitorimi) dhe **Superkontrolli**,
4. **Rikontrolli**

Kontrolli i Parë (kontrolli para miratimit), realizohet pas procesit të vlerësimit dhe përfshinë:

- Kontrollin e aseteve të deklaruara në Planin e Biznesit nga aplikues;
- Verifikimin e parcellave kadastrale;
- Verifikimin e pikave kyçe për të cilat është poentuar aplikacioni.

Çdo mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Kontrollit dhe do të ndikojë në procesin e Miratimit të aplikacionit.

Kontrolli i Dytë (kontrolli pas investimit e para pagesës), realizohet pas kryerjes së investimeve sipas kontratës dhe paraqitjes së pakos së kërkesës për pagesë nga përfituesi dhe përfshinë:

- Kontrollin e seilit pozicion investues sipas tabës për investimet e parapara, Letrës së Informimit dhe kontratës së nënshkruar,
- Verifikimin e cilësisë së investimit,
- Verifikimin e realizimit të standardeve minimale nacionale.

Çdo mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Kontrollit të Dytë dhe do të ndikojë në procesin e Autorizimit të pagesave.

Ex-post Kontrolli (Monitorimi), është proces i monitorimit të projektit të bashkfinancuar nga MBPZHR-AZHB dhe përfituesit, sipas obligimeve të marrura me kontratë, për periudhën 3

vjeçare dhe përfshinë:

- Verifikimin e të gjitha pozicioneve investuese,
- Verifikimin e funksionalitetit të projektit dhe mirëmbajtja e investimeve.

Çdo mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Ex-post kontrollit dhe do t'i drejtohet zyrës ligjore për procedim të mëtutjeshëm.

Superkontrolli është kontroll i veçantë që organizohet me vendim të zyrtarëve siprorë ka për qëllim:

- Verifikimin e investimeve të kryera në terren,
- Pengimin e manipulimeve dhe mashtrimit dhe
- Vlerësimin e punës së inspektoratit.

Rikontrolli është kontrollë që organizohet vetëm në raste të caktuara dhe me kërkesë të drejtorisive përkatëse (Drejtorisë së Miratimit të Projekteve dhe Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave).

Shenim: Kur ka kërkesë për kontroll, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëershme në investimet e bëra, kjo vlen po ashtu edhe nëse kërkohet ndonjë dokument shëtë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodh mos rrespektimi i këtij kushti duhet të bëhet kthimi i menjëershëm i grantit dhë ndëshkimi i aplikuesit.

10.3 Radhitja në listë

Të gjitha projektet që kanë kaluar kriteret e pranueshmërisë, pas kontrollës dhe vlerësimit, duhet të radhiten në listë në bazë të pikëve të fituara dhe eventualisht kohës së aplikimit. Përzgjedhja e përfituesve bëhet duke filluar nga aplikuesi me numrin më të madh të pikëve dhe vazhdon deri sa të shpenzohet buxheti i paraparë

11. PROCEDURAT E DHËNIES SË GRANTIT DHE NJOFTIMI I APLIKUESIT

Pas Kontrollit dhe vlerësimit të projekteve AZHB përgatitë Raportin e Vlerësimit. Projektet klasifikohen si më poshtë:

1) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë dhe 2) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë). Raporti preleminar nënshkruhet nga kryeshefi i AZHB-së dhe publikohet ne web-faqe të AZHB-së dhe web faqe të MBPZHR-së. Të pakënaquritë kanë afat 30 ditë nga dita e publikimit që të vijnë në AZHB dhe të informohen për detajet e vlerësimit dhe marrin raportin me sqarimet rreth vlerësimit ose vendimin përfuzim.

Prej ditës së pranimit të rapportit të vlerësimit apo vendimit përfuzim, aplikuesi ka afat 30 ditë të ushtrojë ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Komisioni i Ankesave merr vendim brenda 30 ditësh, perveç ne raste specifike.

Shenim: Në rast se përfituesi tërhiqet nga implementimi i projektit pas nënshkrimit të kontratës, ai e humbë të drejtën përfuzim.

Përfituesit që pas nënshkrimit të kontratës nuk e implementojnë projektin dhe nuk lajmërohen në AZHB përfuzim, humbin të drejtën përfuzim.

12. PAGESA E PROJEKTIT

Pagesa mund të bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënisë pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin me kërkesën e tije, me kusht të sigurimit të garacionit bankar, ndërsa pjesa tjeter e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.

Nëse përfituesi nuk bënë kërkesë për paradhënie atëherë pagesa e tërësishme bëhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.

Garacioni bankar duhet të sigurohet vetëm për paradhënien prej 50% të përkrahjes publike, përkatesisht deri ne vendimin përfundimtar për pagesë/ pranim te pagesës ose refuzim te pagesës.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen përmes transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

13. DISPOZITA TË RËNDËSISHME QE MUND TË JENË SHKAKTAR I REFUZIMIT TË APLIKACIONIT

Aplikacionet mund të refuzohen nëse nuk janë të kompletuara, nese nuk e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë ose edhe për shkak të numrit të vogël të pikëve.

Shënim: Arsyet e refuzimit duhet të paraqiten dhe sqarohen në Vendimin për refuzim të cilën Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë i'a dërgon aplikuesit.

- Aplikacionet e papranueshme - Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë kontrollës administrative (p.sh. mospërputhje me të dhënrat apo vlerësimë të dokumenteve ose gjatë kontrollës në terren). Projektet e papranueshme nuk i nënshtronen procesit të dhënes së pikëve dhe refuzohen në këtë fazë.

Shënim: Aplikacionet e papranueshme dhe ato të pranueshme por me numër të vogël të pikëve janë pjesë e Raportit të Vlerësimit, të cilin Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë e publikon në web-faqen zyrtare (www.azhb.ks-gov.net) pasi që lista e aplikantëve është e përfunduar dhe nënshkruar nga kryeshefi i AZHB-së Aplikantët duhet të njoftohen me rezultatin e vlerësimit përmes sms-ve me rastin e shpalljes së listës në webfaqe.

13.1 Kontrata mes përfituesit dhe AZHB-së, bashkë me procedurat e prokurimit

Të gjithë përfituesit do të nënshkruajnë një kontratë standarde - shih shtojcën nr 4.

Lista e përfituesve që nënshkruajnë kontratë do të publikohet nga AZHB-ja.

Plani i biznesit ose projekt propozimit së bashku me të gjitha dokumentet e paraqitura bëhet pjesë e kontratës. Kontrata mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri në përfundim të periudhës monitoruese, që është 5 vjet pas implementimit të projektit.

(Nese brenda përiudhes 3 vjecave përfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonje projekti nga MBPZHR, duhet te bëhet një kontroll para nënshkrimit të kontrates së re me AZHB në menyrë që të bëhet verifikimi i projektit të mëparshëm a është funksional, kjo vjen si rrjedhojë e (Jetëgjatësia e kontratës mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja Palët (Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe përfituesi) deri në përfundimin e periudhës monitoruese që është 3 vjet pas zbatimit të projektit).

Périudha e përfundimit të projektit nënkupton përfundmimin e investimit. Kontrata e mbulon edhe përiudhën e monitorimit.

Monitorimi Ex-post

Të gjitha projektet do të monitorohen 3 vite pas Implementimit të Projektit, kontrollimi do të bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Qëllimi i investimit duhet të ruhet edhe 3 vite pas investimit. Gjithashtu, përfituesit duhet të vazhdojnë t'i respektojnë të gjitha kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes për të cilat aplikuesit janë poentuar. Nëse ndodh shkelja e këtyre rregullave, atëherë do të kthehet granti dhe përfituesi do të ndëshkohet me pagesë.

14. LISTA E SHTOJCAVE

- Shtoja 1: Lista e dokumenteve të dorëzuara;
- Shtoja 2: Formulari për Aplikim
- Shtoja 3: Projekt Propozimi
- Shtoja 4: Formulari i Kontratës
- Shtoja 5: Procedurat e prokurimit;
- Shtoja 6: Formulari i Kërkesës për Pagesë për Masën Ujitjes;
- Shtoja 7: Formulari i Indikatorëve;
- Shtoja 8: Forma e Ankesës;
- Shtoja 9: Lista me Adresa të Zyreve Regionale dhe Kontakt.
- Shtoja 10: Promovimi;
- Shtoja 11: Deklarata nën Betim/Zotim;
- Shtoja 12: Deklarata nën Betim Për të drejtën e shfrytëzimit të tokës së trashëguar.

SHTOJCA 1. LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

Nr.	Dokumenti	Obligativ	optional
1.	Formulari për aplikim(Krijohet me rastin e aplikimit online)	<input type="checkbox"/>	
2.	Kopja e letërnjoftimit	<input type="checkbox"/>	
3.	Certifikata e regjistrat të fermerit nif - me anex	<input type="checkbox"/>	
6.	Në rastin e personave juridik: Certifikata e numrit të biznesit- Certifikata e numrit fiskal	<input type="checkbox"/>	

7.	Projektiteknik me paramasë dhe paralogari	<input type="checkbox"/>	
8.	Projekt propozimi i cili përmban arsyeshmërinë ekonomike të investimit	<input type="checkbox"/>	
9.	Pëlqimin e komunës që dëshmon se ne rast të dhënies së grantit, aplikues imund të marrë leje ndërtimi	<input type="checkbox"/>	
10.	kopjet e planit të ngastrave, të cilat do të përfshihen në ujitje	<input type="checkbox"/>	
11.	Skicë (vizatim) në të cilën janë të paraqitura të gjitha ngastrat të përfshira në ujitje me numër të ngastrës nga kopja e planit	<input type="checkbox"/>	
12.	lista e fermerëve që përfitojnë nga sistemi i ujites së propozuar që të ndërtohet/modernizohet/zgjerohet bashkëme NIF-at e tyre (nga Regjistri i Formave)	<input type="checkbox"/>	
13.	Për personat juridik: Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës që dëshmon se aplikanti nuk ka obligime të papaguara ose të rregulluara me ATK. Për personat fizik: Vërtetim nga komuna që ka të shlyer tatimin në prone.	<input type="checkbox"/>	
15.	Certifikata e pronësisë mbi tokën (kopja e planit dhe fleta poseduese ku do të kryhet investimi)	<input type="checkbox"/>	
16.	Deklaratë për të kontribuar me 20% për realizimin e projektit.	<input type="checkbox"/>	
17.	Lista e nënshkruar, e cila përmban edhe numrin e parcelës për të cilën jepet pëlqimi) dhe të dhënat personale (kopja e letërnjoftimit) nga pronarët e tokave për investimin që do të bëhet.	<input type="checkbox"/>	
18.	<ul style="list-style-type: none"> • Deklarata nen betim/Zotim 	<input type="checkbox"/>	
19.	<ul style="list-style-type: none"> • Deklarata nen betim Për të drejtën e shfrytëzimit të tokës së trashëguar(Kur toka është ne vije të drejt te gjakut -obligative) 		<input type="checkbox"/>
20.	Formulari i indikatorev (plotesohet gjate procesit te aplikimit nga aplikuesi	<input type="checkbox"/>	

SHTOJCA 2. FORMULARI PËR APLIKIM - MASA Ujitja e Tokave Bujqësore

SHTOJCA 3. PROJEKT PROPOZIMI;

Përgatitja e projekt propozimit bëhet nga ana e aplikuesit;

Projekt Propozimi duhet të përbajë arsyeshmërinë ekonomike të investimit.

SHTOJCA 4. MODELI I KONTRATËS

Masa/Nën masa.....

Kontrata për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural

Nr.

Në mes të:

Agjencia për Zhvillim e Bujqësisë (AZHB), adresa....., nr i telefonit..... përfaqësuar nga, Drejtori i Agjencisë për Zhvillim e Bujqësisë (AZHB), në njerën anë, dhe

Zotriut./Zonjës.,

Numri personal.....,

Numri Unik i Identifikimit në Regjistrin e Fermerëve....., si person fizik ose si përfaqesues i personit juridik, numri fiskal.....>, adresa.....

....., nr i

telefonit

si përfitues, në anën tjetër,

Në këtë dokument të ashtuquajturat „Palët”,

Pajtohen të nënshkruajnë kontratën sipas kërkesës për pagesë<numrit të regjistrimit>, shtojcave dhe në <titullin> e projektit të paraqitur nga përfituesi dhe shtojcat e saj sipas kushteve të mëposhtme:

Neni. 1 Dispozita të përgjithshme

1.1 Ky dokument duhet të krijojë kornizë juridike dhe operacionale për AZHB për financimin e kërkesës për pagesë të përfituesit < numrin e regjistrimit

1.2 Përfituesi do të financohet sipas kushteve të parapara në kontratë, për të cilat përfituesi deklaron se i njeh dhe i pranon.

1.3 Pjesë obligative të kontratës janë:

- Formulari i aplikimit dhe shtojcat e saj;
- Projekti (plani i biznesit ose projekt-propozimi) dhe shtojcat e projektit të paraqitura nga

përfituesi, pas vlerësimit (pranueshmëria dhe kriterët përzgjedhës për të cilat janë dhënë pikët), së bashku me të gjitha modifikimet që janë bërë gjatë vlerësimit;

Përfituesi është i obliguar të respektoj tërësisht këto kushte gjatë implementimit (deri sa të bëhet pagesa e fundit) dhe 3 vjet pasi që të bëhet pagesa e fundit, gjatë periudhës së monitorimit.

1.4 Përfituesi pranon ndihmën publike dhe do të anagazhohet për zbatimin e projektit në përgjegjësinë e vet duke respektuar dispozitat e kësaj kontrate dhe legjislacionin kombëtar.

Neni. 2 **Implementimi dhe vlefshmëria e konratës**

2.1 Implementimi i konratës fillon prej momentit që kontrata është nënshkruar nga të dyja p alët. Koha e implementimit të investimit është 180 ditë, siç është paraparë në masë dhe paraqet afatin për kërkesën e fundit të pagesës.

2.2 Vlefshmëria e konratës përfshin periudhën kohore prej momentit të nënshkrimit të konratës deri te ekzekutimi i pagesës së fundit dhe 3 vjet të periudhes monitoruese, e cila llogaritet nga data e ekzekutimit të pagesës së fundit.

Neni. 3 **Vlera e Konratës**

- 3.1 Vlera totale e pranueshme e Projektit të financuar është <në nr> dhe (<ne shkronja>).
- 3.2 Vlera totale e pranueshme e Projektit të financuar është (<në shkronja>).
- 3.3 Vlera totale e pranueshme e Projektit të financuar është (<në numra>).

Neni. 4 **Pagesa**

4.1 Pagesa bëhet në dy këste si shpenzime të pranueshme.

4.2 Në rastin kur Përfituesi ka të drejtë të paraqesë 2 kërkesa për pagesë, kërkesa e 1-rë duhet të jetë më e madhe se 50% e totalit të ndihmës publike. Shpenzimet e pranueshme administrative (që kanë lidhje me përpunimin teknik të projektit, planin e biznesit, inxhinieret, arkitektet etj.) mund të kërkohen si rimbursim në përputhje me përqindjen e këstít.

4.3 Pagesa duhet të ekzekutohet duke u bazuar në kërkesën e pagesës së paraqitur nga përfituesi tek AZHB. Autorizimet e pagesës do të behën në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga përfituesi dhe rezultateve të kontrollit sipas udhëzimeve administrative të AZHB. Çdo autorizim i pagesës mund të bëhet jo valid në rast të ndonjë parregullsie të vërejtur, gjatë validitetit të Konratës.

Neni 5
Kontrollimi dhe monitorimi i projektit gjatë validitetit të kontratës

5.1 Përfituesi është i obliguar t'i jap qasje të plotë çfarëdo kontolle të bërë nga AZHB-ja që ka lidhje me investimin e bërë, duke përfshirë të dhënrat mbi punëtorët, kontabilitetin dhe taksat e paguara.

5.2 Në qoftë se AZHB-ja vëren se investimi publik i finançuar nuk është përdorur sipas qëllimit të tyre, planit teknik të projektit dhe planit të biznesit, ose është shitur ose dhënë me qira, AZHB-ja ka të drejtë dhe obligim që të kërkoj kthimin e shpenzimeve të bëra.

5.3 Përfituesi është përgjegjës që të ruaj qëndrueshmërinë ekonomike të investimit dhe të demonstroj dobishmërinë e tij publike.

Neni. 6
Plotësime të Kontratës

6.1 Përfituesi mund të kërkoj që të bëhen modifikime në kontratë vetëm në qoftë se ato nuk ndryshojnë pranueshmërinë dhe rezultatin e projektit dhe vetëm gjatë periudhës implementuese. Sidoqoftë këto modifikime nuk mund të kenë efekt retroaktiv. Modifikimet mund të atakojnë aspektin financier dhe teknik vetëm në qoftë se janë në përputhshmëri me masën, nëse nuk ndryshojnë qëllimin kryesor të projektit dhe nëse janë të limituara në maksimum 10% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

6.2 Mbështetja totale publike që është aprovuar fillimisht nuk mund të rritet në asnë rrëthanë.

6.3 AZHB mund të miratoj ndryshime/plotësime të Kontratës sipas kërkesës së përfituesit, duke u bërë ato pjesë të Kontratës.

6.4 Të drejtat dhe obligimet e kontratës nuk mund të jepen nga përfituesi palës së tretë pa ndonjë marrëveshje specifike nga AZHB. Në kësot raste ADA ka për detyrë që të mbikqyrë në vazhdimësi mirëmbajtjen e pranueshmërisë dhe kriterieve përgjedhës.

Neni. 7
Ndërprerja e Kontratës

7.1 Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të justifikuara drejtë duke përfshirë „force majeure“ në rastet që janë të krijuara dhe komunikuara nga Palët, AZHB mund të vendosë që të ndërprejë kontratën pa pyetur përfituesin që të rifinancoje mbështetjen e marrë publike.

7.2. Palët mund të vendosin në ndërprerjen e Kontratës sipas një marrëveshje të përbashkët, në këtë rast Përfituesi duhet që të kthej të gjithë mbështetjen e marrë publike.

7.3 Në rast të vërejtjes së ndonjë parregullësie në ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë rastet kur përfituesi nuk është në gjendje që të bëj pagesën apo ka falimentuar, ose nëse është vërejtur se dokumentet e ofruara janë të rrëme/skaduara/jo të plota/nuk pasqyrojnë realitetin, atëherë AZHB duhet të ndërprejë kontratën në kuptimin e njoftimit me shkrim adresuar përfituesit, pa asnjë

vonesë dhe pa asnje formalitet tjetër dhe pa ndërhyrje të ndonje ligji të Gjykatës. Në rast të tillë përfituesi duhet të kthej tërë mbështetjen e marrë.

7.4 Në çdo kohë në rast të ndonje dyshimi AZHB mund të suspendoje përkohësisht kontratën dhe pagesat si masë paraprake deri në përfundim të hetimeve, pa ndonjë njoftim.

Neni. 8
Forcë madhore

8.1 Sipas forcës madhore, pala është e përjashtuar nga përgjegjësitë që parashihen me këtë kontratë.

8.2 Forcë madhore është përcaktuar si një ngjarje, e cila është e paparashikueshme dhe e pamundur për t'u shmangur nga Palët pas nënshkrimit të kontratës dhe që mbron kontratën për t'u ekzekutuar.

8.3 Si forcë madhore mund të konsiderohen rastet siç janë: tërmetat, vërshimet, lufta, revolucionet, embargot etj.

8.4 Çdo rast forcë madhore duhet të dëshmohet dhe pranohet nga AZHB.

Neni. 9
Komunikimi mes Palëve

9.1 Çdo këmbim i informatës në lidhje më këtë kontratë duhet të jetë në formë të shkruar: direkt, me email ose fax.

9.2 Njoftimet verbale nuk do të merren parasysh në qoftë se nuk janë bërë edhe njoftime në formë të shkruar siç u permend në nenin 9.1.

Nënshkruar nga përfaqësuesi i AZHB-së

Emri dhe Mbiemri
Nënshkrimi

Data _____

Nënshkruar nga Përfituesi
ose përfaqësuesi i tij ligjor
Emri dhe Mbiemri
Nënshkrimi

Data _____

SHTOJCA 5. PROCEDURAT E PROKURIMIT

PROCEDURAT E PROKURIMIT

(të jenë të bashkangjitura bashkë me kontratën e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për përfituesit)

1. Dispozitat e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha llojet e blerjeve

- Të gjithë ofertuesit duhet të plotësojnë Rregullën e origjinës - për detaje shih dispozitat dhe shtojcat e tjera relevante në Udhëzuesin e Aplikuesit;
- Asnjë nënkontraktues nuk mund të krijojë marrëdhënie kontraktuale në mes të ndonjë nënkontraktuesi tjetër dhe Përfituesit;
- Blerjet duhet të respektojnë investimet që përbushin kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në kuadër të masave dhe udhëzimeve të planit të biznesit p.sh. për sa i përket kthimit të investimeve, rrjedhës së parasë etj.
- Procedurat e prokurimit vlejnë vetëm për investimet e pranueshme, për investimet e papranueshme nuk janë të obligueshme procedurat e prokurimit;
- Ka 3 lloje të procedurave: blerjet e drejtpërdrejta, blerjet me së paku 3 oferta dhe përzgjedha bazuar në prokurimin me shpallje publike (tender i hapur);
- Procedura për blerjet që do të aplikohen është në varësi të vlerës së blerjeve; Është e ndaluar ndarja e blerjeve për llojin e njëjtë të mallrave, punimeve apo shërbimeve me qëllim të shmangies së rregullave procedurale të aplikueshme për një prag më të lartë;
- Ofertuesit nuk duhet të jetë në konflikt të interesit;
- Në rastin e shtrembërimit të informacionit të kërkuar nga Përfituesi ose dështojnë për të dhënë këtë informacion, ofertuesit do të përjashtohen nga dhënia e kontratave;
- Respektimi i rregullave të prokurimit është një kusht i detyrueshëm për tu pranuar shpenzimet. Prandaj, dosja e kërkesës duhet të përbajë dokumentet e pagesave për të provuar plotësimin e procedurave të prokurimit, shih Shtojcën 5.

2. Kriteret e dhënies së kontratës

Kontratat duhet të jepen duke u bazuar në këto kriterë:

- A. Në rast të furnizimit me mallra- të bazuar në çmimin më të ulët;
- B. Në rastin e ndërtimit(nënkuption rezultatin e ndërtimit ose projektit të inxhinierisë që vetveti është e mjaftueshme të plotësojë një funksion ekonomik ose teknik dhe mbulon të dyja dizajnimin dhe ekzekutimin) - bazuar në çmimin më të ulët;
- C. Në rast të shërbimeve(studime ose për ndihmë teknike) - bazuar në çmimin më të ulët;

3. Përkufizimi i konfliktit të interesit

- Ekzistimi i lidhjeve ndërmjet përfituesit dhe furnizuesit (të afërmit, apo aksionarë të përbashkët në kompanitë ofertuese) ose në mes te anëtarëve të Komitetit Vlerësues;
- Pronësia e përbashkët (si individ ose si aksionar) në mesin e furnizuesve të cilët dorëzojnë oferta.

4. Procedurat e blerjes:

4.1 Blerjet direkte deri në 10,000.00

euro. Rregullat:

- Përfituesi mund të blej drejtpërdrejt nga tregu;
- Kostoja e blerjes duhet të respektojë pragjet e vendosura në masë;
- Nuk ka nevojë për një kontratë të nënshkruar në mes të shfrytëzuesit dhe furnizuesit, përveç në rast të shpenzimeve të konsulencës;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e çertifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe kopjen e çertifikatës së Numrit Fiskal të ofertuesve.

4.2 Përzgjedhja bazuar në të paktën 3 oferta duke filluar prej 10,000.01 deri në 60,000.00 euro.

Rregullat:

- Blerjet mund të bëhen vetëm me së paku 3 oferta (kuotim i çmimit);
- Shpenzimet brenda ofertës duhet të respektojnë edhe pragjet e vendosura brenda masave;
- Në të gjitha rastet, duhet të nënshkruhet kontrata në mes të përfituesit dhe furnizuesit;
- Ftesat për oferta, ofertat dhe kontrata duhet të respektojnë dispozitat/detajet e të cilave janë paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe brenda planit të biznesit;
- Përfituesi duhet të dërgojë një ftesë për oferta, duke respektuar një format standard-shih Aneksin 1;
- Furnizuesit duhet të regjistrojnë ofertën e tyre në regjistrin e hyrje/daljeve;
- Përfituesi duhet të nënshkruajë Deklaratën për respektimin e rregullave për shhangjen e konfliktit të interesit-shih Shtojcën 2;
- Ofertuesit duhet të nënshkruajnë Deklaratën e tenderuesit te besueshëm-shih Shtojcën 3;
- Përfituesi do të vodosë për dhëni e kontratës ofertuesit me argumente;

Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe kopjen e certifikatës së Numrit Fiskal të ofertuesve.

4.3 Prokurimi me shpallje publike (tender i hapur) - duke filluar nga 30,000.01 deri në 60,000.00 euro

Rregullat:

Përfituesi duhet të publikoj interesin e tij për blerjen, së paku përmes një gazete të përditshme kombëtare, por në qoftë se vlera është më e lartë se 150.000 € tenderi duhet të paraqitet edhe në mediat ndërkombëtare. Përveç kësaj, përfituesi ka të drejtë të dërgoj direkt ftesat për furnizuesit e mundshëm për të siguruar një konkurrencë më të mirë në mesin e ofertave, por vetëm në të njëjtën ditë kur është shpallur tenderi;

Përbajtja e ftesës publike duhet të përfshijëtë gjithë informacionin e paraqitur në Shtojcën 1 të kontratës.

Afat kohor për marrjen e ofertave duhet të jetë të paktën 10 ditë;

Përfituesi do të krijojë një komision vlerësimi; Ky komision duhet të ketë një numër të tek të anëtarëve, të paktën tre, me të gjitha kapacitetet teknike dhe administrative të nevojshme për të dhënë një opinion të vlefshëm mbi tenderët;

Komisioni i vlerësimit duhet të lëshojë një vendim të argumentuar për dhënien e tenderit;

Anëtarët e komisionit të vlerësimit duhet të nënshkruajnë një deklaratë të konfidencialitetit dhe neutralitetit-shih Shtojcën 4.

Të gjitha kërkesat për pjesëmarrje dhe tenderët që i plotësojnë kërkesat, duhet të vlerësohen dhe renditen nga komisioni i vlerësimit në bazë të kritereve të përgjedhjes dhe dhënie së kontratës të shpallura paraprakisht;

Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e çertifikatës së Regjistrimit të Biznesit dhe kopjen e çertifikatës së Numrit Fiskal të ofertuesve.

SHTOJCA 6. FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË PËR MASËN UJITJE

Kërkesa për pagesë

(Nënshtetësia e përfituesit)

(Nënshtetës i zyrtarit komunal)

VII. Numri i Regjistrimit të Fermës

Numri i Regjistrimit të Fermës

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

VIII. Përshkrimi i përfituesit

Për Subjektet Juridike:

Numri i Regjistrimit të Biznesit	<table border="1"><tr><td> </td><td> </td></tr></table>												
Statusi ligjor													

Për të gjithë përfituesit:

Banka	Emri i Bankës:																								
	Kodi IBAN:																								
	Numri i gjirologarisë:	<table border="1"><tr><td> </td><td> </td></tr></table>																							
Adresa:																									
Personi fizik apo i autorizuar																									
Emri	Numri i	<table border="1"><tr><td> </td><td> </td></tr></table>														Identitetit									
.....	Numri i	<table border="1"><tr><td> </td><td> </td></tr></table>														letërnjoftimit									
Mbiemri	E-maili:																							

IX. Vendndodhja e Projektit

Vendndodhja e Projektit	Rajoni:			
	Komuna:			
	Vendbanimi:			
	Rruga Nr:			
	Kodi Zip:			
X. Kërkesë për:				
X.1. Shuma totale e shpenzimit (me TVSH):	X.2 Shuma e përkrahjes		X.3 Bashkëfinancimi i përfituesit	
Euro	Euro	%	Euro	%

XI. Deklaratat				
<p>Me nënshkrimin e kësaj kërkesë për pagesë Unë deklaroj se:</p> <p>Të gjitha të dhënat, informatat dhe dokumentet, të cilat unë i kam paraqitur me këtë kërkesë për pagesë janë të vërteta.</p> <p>Investimet e përfshira në kërkesën për pagesë janë kryer me të vërtetë.</p> <p>Kostot për të cilat unë dëshiroj të paguhem janë të pasqyruara në Tabelën e Kostove të kësaj kërkesë për pagesë.</p> <p>Unë nuk kam marrë përkrahje tjetër financiare publike për të njëjtat investime. Unë nuk kam borxhe të prapambetura në institucionet publike.</p> <p>Unë jam dakord që Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ta publikojë këtë informacion për projektin tim – emrin e përfituesit, vendndodhjen e investimeve, shumën e përkrahjes dhe shumën totale të kostove</p>				
XII. Data / Nënshkrimi				
Dita – muaji – viti/...../..... / (Emri, mbiemri dhe nënshkrimi) (Vula për subjektet juridike)			

Shënim: Përfituesi plotëson vetëm hapësirat me ngjyrë të bardhë

SHTOJCA 7. FORMULARI I INDIKATORËVE

Masa: Skema Nacionale e granteve për Ujitjen e Tokave Bujqësore - Viti 2020- 21

Komuna.....

Mbledhja e treguesve për
projektin..... Aplicant

Numri identifikues i fermerit

--	--	--	--	--	--

Lloji i treguesit	Treguesi		Të dhënata e ofruar nga Aplikuesi	Kontroll nga Azhb
Input	Vlera totale e ndihmës publike (euro)			<input type="checkbox"/>
Output	*Vëllimi i përgjithshëm i investimit (euro)			<input type="checkbox"/>
Rezultati	Investimet do të shkojnë në rritje të sipërfaqeve të ujitura, nëse po madhësia e sipërfaqes (ha)			<input type="checkbox"/>
	Sistemi i modernizuar i ujitjes mundëson ujitje për sipërfaqen bujqësore në madhësi për (ha)			<input type="checkbox"/>
	Rritja totale e prodhimit (në tonë/për vit) në sipërfaqet e ujitura si rezultat i investimit direkt, si në vijim	Dritërat		<input type="checkbox"/>
		Perimet (përfshirë patatet)		<input type="checkbox"/>
		Frutat		<input type="checkbox"/>
		Rrushi		<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>

Ndikimi Vlera totale prodhimit bujqësor shtesë (euro/vit)

* - shpenzimet e pranueshme (mbështetja publike + bashkë-financimi privat i shpenzimeve të pranueshme) + shpenzimet e papranueshme

SHTOJCA 8. FORMA E ANKESËS

Ankesë

Emri Mbiemri _____

Fshati _____ Komuna _____

Ankohem ndaj: _____ nr. _____ i dt. _____,
si aplikues i

Projektet e Zhvillimit Rural: *Sektori:* Nr. i Aplikacionit _____

Pagesat Direkt: Të tjera _____ Nr.i Aplikacionit _____

Shkaqet e ankimit:

Nënshkrimi _____

Vërejtje: Bashkëngjit dokumentet që i konteston

**SHTOJCA 9. LISTA DHE ADRESA E ZYRËS QENDRORE DHE
ZYREVE REGJIONALE TË AZHB-së.**

MBPZHR / AZHB

Adresa: Rr: Ukshin Hoti 10,000 Prishtinë - Kompleksi „Ramiz Sadiku,, kati IIX nga e Hëna deri të Premten nga ora 10:00 – 12:00 dhe 13:00 – 15:00
Tel. 03820038871 ose 3820038421

Çdo ditë pune nga ora 08:00 - 16:00				
Nr.	Regioni	Adresat	Telefoni	e-maili
1	Prishtina	“Zona Industriale” - Fushë Kosovë, përballë “Maxi-Marketit”,	038 601 - 169	
2	Mitrovica	“Mbretëresha Teutë” pa nr.	028 522 - 501	
3	Peja	Instituti Bujqësor i Kosovës – “Fidanishtja” - Pejë	039 431 - 276	
4	Gjakova	“Marin Brleti” nr.2, kati III.	0390 320 - 992	
5	Prizreni	“Avni Rrustemi” 159	029 244 - 793	
6	Ferizaji	“Dëshmoret e Kombit” p.n.	0290 324 - 661	
7	Gjilani	Rr: “Bulevardi i Pavarësisë” (Rr. e Ferizaj-it soliteri kati I)	0280 326 - 106	

SHTOJCA 10. PROMOVIMI

Të gjithë përfituesit duhet t'i respektojnë rregullat e promovimit të përcaktuara nga institucioni financues. Të gjithë përfituesit e granteve nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, para kërkesës për pagesën e fundit, në vendin e investimit, duhet të vendosin një tabelë siç është paraqitur në këtë shtojcë. Kjo tabelë duhet të vendoset në vend të dukshëm, me madhësi: 100 cm x 50 cm, e punuar nga plastikë e fortë, e shkruar me ngjyrë të qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike



SHTOJCA 11. Deklarata nën Betim/Zotim



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarskta i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development*
*Agjencija për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/The Agriculture
Development Agency*

DEKLARATË NËN BETIM/ZOTIM

Unë _____ me numër personal _____

Adresa: _____, me përgjegjësi të plotë ligjore penale deklaroj nën betim se me nënshkrimin tim dhe bashkangjitet e dokumenteve në aplikimin online siguroj që të gjitha dokumentet, informatat dhe të dhënat që janë prezantuar në aplikim për Programin e ZHR 2020-21 janë të qarta, të besueshme dhe të sakta dhe se për çdo paqartësi, jo saktësi dhe falsifikim do mbajë përgjegjësi ligjore dhe penale.

Datë _____.2020

Nënshkrimi i Deklaruesit

SHTOJCA 12. DEKLARATË NËN BETIM



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarskoga i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencija për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture Development
Agency*

DEKLARATË NËN BETIM

Për të drejtën e shfrytëzimit të tokës së trashëguar

në _____ me numër personal _____

Adresa: _____, me përgjegjësi të plotë morale dhe penale nën betim deklaroj se personi emri i të cilit është në fletën poseduese të tokës, me të cilën aplikoj për Projekt të zhvillimit rural për programin 2020-21, në AZHB-MBPZHR është: _____ (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, bashkëshortët etj), këtë e dëshmoj përmes çertifikatës së _____, si shfrytëzues i ligjshëm i tokës.

Nënshkrimi i Deklaruesit

Data ____/____/____

*Ky dokument është perbatitur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në
bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues dhe shpërndahet falas*